



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:032976

Datë: 05.05.2023

Numri i dokumentit: 04253237

P.nr.184/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermahaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurit A.S nga Gjilani për shkak të veprës penale kanosja nga neni 181 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-ës, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati Hasan Sadiku nga Gjilani, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.358/2022, të datës 28.02.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik me datë 26.04.2023 në të cilin kanë prezantuar prokurorja e shtetit Leonora Kadriu, i dëmtuari F.Z, i pandehuri A.S dhe mbrojtësi i tij avokati Hasan Sadiku, mori dhe shpalli ndërsa me datë 05.05.2023 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri A.S, nga babai A dhe nëna M, e lindur H, i lindur me datë .... në Gjilan ku edhe jeton, rruga..., student, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, identifikuar me numër personal ...

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 17.02.2022 rreth orës 22:00, në rrugën ...në Gjilan, respektivisht tek Kafiteria ... i pandehuri A.S paraprakisht kishte mosmarrëveshje me disa persona tjerë e që ndërhyjnë personat zyrtar F.Z duke u prezantuar si policë e më pas edhe F.K që i pandehuri nuk i përfill dhe fillon ta shaj ofendoj me fjalë të ndryshme dhe me pas është larguar nga vendi i ngjarjes e që me vonë është lajmëruar në stacion Policor dhe posa e vëren zyrtarin policor F i thotë se “ju njoh juve personalisht” e më pas zyrtarit policor F.Z i është drejtuar duke i thënë “ Un ta dij shpijën në .....dhe do te vij atje” e më pas edhe në stacion policor kanos të dëmtuarin F prap me fjalë “un ja dij atij shtëpin në ....., do të shkoj atje e do ta kalli” me çka tek i dëmtuari ka shkaktuar ndjenjën e frikës, ankthit dhe pasigurisë për veten e tij.

-Me çka ka kryer veprën penale kanosja nga neni 181 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 38, 39, 40, 43, 44, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së dhe neneve 322 e 364 të KPP-së të pandehurën e lartcekur:

### E GJYKON

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëtdhjetë) ditësh i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit dhe në bazë të nenit 44 të KPRK-ës I ZËVENDËSOHET në dënim me gjobë në shumën prej 1000 € (njëmijë euro), të cilën obligohet ta paguajë në afat prej 2 (dy) muajve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

Në bazë të nenit 79 të KPRK-ës të pandehurit të lartcekur koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak nga data 17.02.2023 deri me datë 11.03.2023 do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me gjobë.

Meqenëse i dëmtuari ka deklaruar se nuk i bashkangjitet ndjekjes penale ndaj të pandehurit si dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike rrjedhimisht edhe gjykata nuk vendosi për kërkesën pasurore juridike.

Obligohet i pandehuri që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro) si dhe shumën prej 20 € (njëzet euro) për kompensimin e viktimave të krimit të cilat i akuzuari të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

### ARSYETIM

#### 1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjiilan- Departamenti i Përgjithshëm, me datë 28.02.2022, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.358/2022 kundër të pandehurit A.S nga Gjilani për shkak të veprës penale kanosja nga neni 181 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-ës.

Me datë 26.03.2023 pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit gjyqësor në të cilën kanë prezantuar prokurorja e shtetit Leonora Kadriu, i dëmtuari F.Z, i pandehuri A.S dhe mbrojtësi i tij avokati Hasan Sadiku. Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar plotësisht aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe

se e pranon fajësinë për kryerjen saj, pranim ky i cili është mbështetur edhe nga mbrojtësi i tij, me ç' rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 322 të KPP-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit dhe seanca kishte vazhduar me fjalët përfundimtare të palëve.

Prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pasi që në shqyrtimin gjyqësor i pandehuri e pranoi veprën penale sipas dispozitivit të aktit akuzues, të cilin pranim e bëri në mënyrë vullnetare duke i ditur pasojat dhe benefitet të cilat i sjellë pranimi i fajësisë, e të cilin pranim e bëri pas konsultimeve me mbrojtësin e tij kërkon nga gjykata që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj me dënim të paraparë me ligj duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat si ato lehtësuese po ashtu edhe ato rënduese.

I dëmtuari në fjalën përfundimtare ka deklaruar sa i përket ndjekjes penale dëshiron që të pandehurit t'ia fal, me të njëjtin më nuk ka pasur probleme dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.

Mbrojtësi i të akuzuarit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se si mbrojtës i të akuzuarit i propozon gjykatës që me rastin e matjes së lartësisë së dënimit si rrethanë posaçërisht lehtësuese ta merr pranimin e fajësisë si dhe faktin tjetër se i dëmtuari në rastin konkret nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale ndaj të pandehurit dhe nuk ka kërkuar dëmshpërblim.

I akuzuari në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështetë në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim, i vie keq për veprimet që i kam bërë, është penduar, premton që në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, i kërkon falje të dëmtuarit, premton që nuk do të bie ndesh me ligjin, nga ky rast nuk kam pasur problem as me të dëmtuarin dhe me askënd tjetër, kërkon falje për këtë veprim dhe kërkoj nga gjykata një dënim sa më të butë.

## 2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata në seancën e shqyrtimit gjyqësor në të cilin kanë prezantuar palët e lartcekura pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 322 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza lëndore siç janë: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2022-CA-0198 i datës 17.02.2022, raportet e oficerëve, deklarata e të dëmtuarit, deklaratat e dëshmitarëve, deklarata e të

pandehurit si dhe raporti i shpejtë i përpiluar nga oficeri policor, po ashtu me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

### 3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartë cekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: i pandehuri A.S nga Gjilani ka kryer veprën penale kanosja nga neni 181 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-ës në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### 4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij ashtu që me rastin e matjes së dënimit gjykata mori parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës siç janë shkalla e përgjegjësisë penale të kryesit, pranimi i fajit nga ana e të pandehurit, rrethanat personale të tij si dhe sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata është bazuar edhe në rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës me ç'rast si rrethana lehtësuese për të pandehurin mori pranimin e fajësisë nga ana e tij për kryerjen e veprës penale, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, keqardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurit për veprimet e ndërmarra, kërkim faljen e tij në drejtim të dëmtuarit përfshirë edhe atë në gjykatore, premtimin e tij që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera si dhe faktin se pas këtij rasti i njejtë nuk ka pasur probleme me të dëmtuarin dhe nuk ka rënë ndesh me ligjin ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata nuk gjeti ndonjë andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës gjykata të pandehurit i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjithnjë duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprës penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë gjykata pati parasysh edhe gjendjen ekonomike të pandehurit sipas të cilit është mesatare, e me të cilin dënim gjykata konsideron se të njëjtit por as familjarëve të tij nuk u cenohet mirëqenia ekonomike.

#### 5. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

Meqenëse i dëmtuari ka deklaruar se nuk i bashkangjitet ndjekjes penale ndaj të pandehurit si dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike rrjedhimisht edhe gjykata nuk vendosi për kërkesën pasurore juridike.

#### 6. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurit si dhe bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta detyroj të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro) si dhe shumën prej 20 € (njëzet euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.184/2022, me datë 05.05.2023

Zyrtarja Ligjore,  
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Rilind Sermaxhaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan.